



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-102

Prishtinë, më 2 prill 2013, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 2 PRILL 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që pika 2.3 të hiqet nga rendi i ditës dhe këtë e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 25 mars 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 25 mars 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 25 mars 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 29 mars 2013, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 4 prill 2013 në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i rekomandimeve të debatit parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,*
2. *Votimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011,*
3. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.*

Ndërsa për mbledhjen plenare të radhës, Kryesia vendosi që ajo të mbahet të enjten, më 4 prill 2013, me fillim në orën 13:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e pagesave,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontrollin e duhanit,*
5. *Interpelanca e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, sipas kërkesë së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dyshimet për keqpërdorimet në Ministrinë e*

Punëve të Brendshme, përfshirë kontratën e pasaportave biometrike me kompaninë austriake (OESD),

6. Debat parlamentar lidhur me raportet e institucioneve ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,

7. Debat parlamentar lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,

8. Debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimitarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues,

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjin nr. 04-L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,

10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,

11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012,

12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012,

13. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i propozim-Planit Strategjik të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për periudhën 2013-2018

Sekretari i Kuvendit e arsyetoi para Kryesisë propozim-Planin Strategjik të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për periudhën 2013-2018. Ai theksoi se prioritetet e paraqitura në këtë plan kanë të bëjnë me Administratën e Kuvendit dhe në të parashihen edhe bartësit e objektivave që synohet të realizohen me të, veprimet konkrete që ata duhet t'i kryejnë, afatet kohore, si dhe kostoja buxhetore.

Ndërsa, kryetari i Kuvendit u përqendrua në sqarimin e përmbajtjes së Planit Strategjik të Kuvendit për periudhën 2013-2018; caktimi i objektivave, organet përgjegjëse për zbatimin e tyre, veprimet konkrete apo aktivitetet me të cilat ato do të arrihen, afati kohor për zbatimin e tyre dhe burimi financiar apo kostoja financiare për realizimin e projekteve.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-Planin Strategjik të Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2013-2018, konstatoi se miratimi i këtij plani do të bëhet në mbledhjen e radhës së Kryesisë, pasi në këtë plan të inkorporohen vërejtjet e dhëna nga kryetari i Kuvendit.

2. Propozim-Rregullorja për orarin e punës dhe kompensimet për nëpunësit civilë të Administratës së Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për orarin e punës dhe kompensimet për nëpunësit civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
2. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit që ta zbatojë këtë Rregullore,
3. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

3. Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së për debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që për këtë çështje të veprohet për procedim të mëtejme sipas Rregullores së Kuvendit.

4. Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së për debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që për këtë çështje të veprohet për procedim të mëtejme sipas Rregullores së Kuvendit.

5. Kërkesa e Grupit Parlamentar të SLS-së për formimin e Komisionit për Standardizim të Gjuhëve në Kuvendin e Kosovës

Për kërkesën e Grupit Parlamentar të SLS-së për formimin e Komisionit për Standardizim të Gjuhëve në Kuvendin e Kosovës diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që projektligjet që i harton dhe procedon në Kuvend për miratim të jenë të harmonizuara sipas standardit gjuhësor të gjuhëve përkatëse shqipe, serbe dhe angleze.
2. Obligohet Administrata e Kuvendit që ta punësojë edhe një zyrtar në Drejtorinë për Standardizim dhe Përafrim për t'i harmonizuar të gjitha dokumentet që hartohen nga trupat punues të Kuvendit.
3. Obligohet Drejtoria e Shërbimit Gjuhësor që të gjitha dokumentet që hartohen nga trupat punues të Kuvendit të përkthehen dhe të lekturohen sipas standardit gjuhësor të gjuhëve zyrtare në Kosovë.

6. Kërkesa e deputetes Alma Lama për procedimin e Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision FunkSIONAL, që ta procedojë për mbledhje plenare në afat sa më të shkurtër Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.

7. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012

Kryesia u njoftua nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm - kompania audituese “BDO KOSOVA”, për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

8. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian për vizitën e realizuar në Sarajevë

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Integritet Evropian, të realizuar në Sarajevë, prej datës 21-22 mars 2013.

Pikat shitesë:

1. Kërkesa e G/P të LDK-së për mbajtjen e një seance solemne me rastin e shënimit të përvjetorit të Betejës së Koshares

Për kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së për mbajtjen e një seance solemne me rastin e përvjetorit të Betejës së Koshares diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit; si dhe kryetarët e grupeve parlamentare Ismet Beqiri dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që të hënën, më 8 prill 2013, në orën 12:00, të mbahet seanca plenare për nder të shënimit të 14-vjetorit të Betejës së Koshares.

3. Marrëveshja e G/P “6+” për ndërrimin me rotacion të nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia e radhiti këtë marrëveshje në rend dite për mbledhjen e rregullt plenare, më 4 prill 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale